



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**-KOMISIONI I KONKURRENCËS -**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më 07/04/2011

**V E N D I M**

**Nr. 184, Datë 07.04.2011**

**“Për  
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe  
tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”**

**Objekt:** Ekzistencën ose jo të një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve të prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës.

**Baza ligjore:** Neni 28, shkronja b); neni 29, pika 2, shkronja b) dhe c); neni 4, pika 1 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 07.04.2011, pasi mori në shqyrtim relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me monitorimin e realizuar nga Inspektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut në lidhje me kufizimet e mundshme të konkurrencës në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës.

**VËREN SE:**

Në datë 25.03.2011 në median e shkruar dhe atë vizive, janë botuar disa artikuj në lidhje me rritjen e çmimit të bukës qytetin e Vlorës.

Bazuar në artikujt e mësipërm rezultoi që çmimi i bukës është rritur në mënyrë të menjëhershme nga të gjithë prodhuesit dhe tregtuesit e bukës dhe se çmimi i bukës ka arritur çmimin 120 lek.

Nga monitorimi i realizuar u konstatua se rritja e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës ka ardhur në mënyrë të menjëhershme, pas një mbledhje të

rreth 42 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës ku është rënë dakord se që nga data 23.03.2011 çmimi i bukës 900 gr do të jetë 120 lek dhe çmimi i bukës 450 gr. do të jetë 60 lek.

Sjellja e këtyre ndërmarrjeve për fiksimin e çmimit të shitjes së bukës në qytetin e Vlorës në kuptim të nenit 4, pika 1, germa a) të Ligjit Nr 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar është marrëveshje e ndaluar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”i ndryshuar ,

### **V E N D O S I:**

- I. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës ne qytetin e Vlorës për ekzistencën ose jo te një marrëveshje te ndaluar dhe efektet e saj ne tregun perkates.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 22.04.2011

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**Servete GRUDA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Rezana KONOMI**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Koço BROKA**

(\_\_\_\_\_)  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**K R Y E T A R**